

35324

Nr. 35324

V E N D I M
PER RREGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK
TE SHOQERISE TREGTARE "LEGEA" SH.P.K

Ne Tirane, sot ne date ^{18/}03.2006, une Enkela Bajo, gjyqtare prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, pasi mora ne shqyrtim kerkesen dhe dokumentat e paraqitura nga kerkuesi Ylli Tomorri, i biri i Skenderit dhe i Vites, dtl. 04.11.1950, me shtetesi dhe kombesi Shqiptare lindur dhe banues ne Tirane ne adresen Rr. "Kavajes", Pallati. "SPEED", Shk.1, Ap. 12/1, madhor me zotesi te plota juridike dhe per te vepruar ne cilesine e ortakut themelues dhe administrator i shoqerise tregtare "LEGEA" sh.p.k;

KONSTATOVA

Se kerkuesi Ylli Tomorri, sipas aktit te themelimit dhe statutit te shoqerise eshte emeruar administrator i shoqerise "LEGEA" sh.p.k.. Me kete cilesi ai i eshte drejtuar gjykates me kerkese per rregjistrimin si person juridik te shoqerise qe ai perfaqeson ne rregjistrin tregtar.

Sipas aktit te themelimit dhe statutit te shoqerise ortakët themelues jane:

1. Ylli Tomorri, i biri i Skenderit dhe i Vites, dtl. 04.11.1950, me shtetesi dhe kombesi Shqiptare lindur dhe banues ne Tirane ne adresen Rr. "Kavajes", Pallati. "SPEED" Shk.1, Ap. 12/1.
2. Fatmir Hajdini, i biri i Asllanit dhe i Anifes, dtl. 15.01.1953, me shtetesi dhe kombesi Shqiptare lindur dhe banues ne Tirane ne adresen Rr. "Kavajes", Pallati. "SPEED", Shk.1, Ap. 7/3, madhor me zotesi te plota juridike.
3. Kejdi Tomorri, i biri i Yllit dhe i Ermires, dtl. 20.04.1980, me shtetesi dhe kombesi Shqiptare lindur dhe banues ne Tirane ne adresen Rr. "Kavajes", Pallati. "SPEED" Shk.1, Ap. 8/1, madhor me zotesi te plota juridike dhe per te vepruar.

Emri i shoqerise eshte "LEGEA" sh.p.k.

Selia e saj eshte ne Tirane, ne adresen Rr. "Kavajes", Pallati. "SPEED" Shk.1, Ap. 8/1.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke i derdhur teresisht dhe i ndare si me poshte :

- | | |
|-------------------|-----------------------------------|
| Z. Ylli Tomorri | 33.000 (tridhjetetremije) leke . |
| Z. Fatmir Hajdini | 33.000 (tridhjetetremije) leke. |
| Z. Kejdi Tomorri | 34.000 (tridhjetekatermije) leke. |

Objekti i veprimtarise se ketij subjekti juridik do te jete:

Import Eksport, tregtim me shumic e pakic, te mallrave te ndryshme si konfeksione, ushqimore, industriale e sportive.

Pervec sa me siper, ne veprimtarine e shoqerise do te hyje cdo veprimtari tjeter industriale e tregtare, qe do te konsiderohet nga ortaket, e nevojshme dhe e pershtatshme per arrijten e objektit te shoqerise.

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj per te realizuar fitimin, duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit, sigurise dhe rentabilitetit si dhe vetem mbi bazen e legjislacionit shqiptar. Shoqeria i ka te gjitha autorizimet ne marredheniet juridike me persona te trete.

Perfaqesues Ligjor dhe Administrator i shoqerise do te jete z. Ylli Tomorri qe eshte dhe ortak themelues i shoqerise.

Kohezgjatja e veprimtaris se shoqerise do te jete 20 vjet.

Per sa me siper konstatoj se kerkesa e kerkuesit Ylli Tomorri eshte e drejte dhe duhet te pranohet.

PER KETO ARSYE

Mbeshtetur ne ligjin Nr. 7638, te dates 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", ligjin Nr. 7667, date 11.01.1993 "Per Rregjistrin Tregtar"

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses se kerkuesit Ylli Tomorri.

Regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "LEGEA" sh.p.k

Emri i shoqerise do te jete "LEGEA" sh.p.k

Ortak themelues te shoqerise jane shtetasit shqiptare Ylli Tomorri, Fatmir Hajdini dhe Kejdi Tomorri

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke, i derdhur dhe ndare si me posht:

z. Ylli Tomorri 33.000 (tridhjetetremije) leke .

z. Fatmir Hajdini 33.000 (tridhjetetremije) leke.

z. Kejdi Tomorri 34.000 (tridhjetekatermije) leke.

Selia e shoqerise do te jete ne Tirane, ne adresen Rr. "Kavajes", Pallati. "SPEED" Shk.1 , Ap. 8/1.

Administrator dhe perfaqesues ligjor i shoqerise eshte z. Ylli Tomorri.

Afati i veprimtarise se shoqerise do te jete 20 vjet duke filluar qe nga dita e regjistrimit ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Objekti i veprimtarise se ketij subjekti juridik do te jete:

Import Eksport, tregtim me shumic e pakic, te mallrave te ndryshme si konfeksione, ushqimore, industriale e sportive.

Pervec sa me siper, ne veprimtarine e shoqerise do te hyje cdo veprimtari tjeter industriale e tregtare, qe do te konsiderohet nga ortaket, e nevojshme dhe e pershtatshme per arrijten e objektit te shoqerise.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit

GJYQTARE
Enkela BAJO



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

Nr. 35324 / Regj.

VENDIM
I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirana, sot me datë 25/04/2007, une gjyqtari J. Doryn, pasi mora ne shqyrtim kerkesen dhe dokumentat e paraqitura prej, z. Ylli TOMORI, i biri i Skenderit i datelindjes 04.11.1950, lindur dhe banues ne Tirane, ne adresen: rruga e "Kavajes" pallatet "SPEED" shk. 1 ap.12/1; Administrator i Shoqerise Tregtare "LEGEA" sh.p.k

KONSTATOVA

Se shoqeria Tregtare "LEGEA" sh.p.k., eshte nje person juridik shqiptar i regjistruar ne regjistrin tregtar prane Gjykares se Rrethit Gjyqesor Tirane me vendimin Nr.35324 Akti dt.28.03.2006. Qe nga data e krijimit te saj, kjo shoqeri, sikurse rezulton dhe nga vendimi i Asambles se Ortakve dhe kerkesa e paraqitur, ka ushtruar nje aktivitet tregtar ne perputhje me objektin e veprimtarise te percaktuar ne statutin dhe aktin e saj te themelimit.

Ne date 05.04.2007 kjo shoqeri ka realizuar mbledhjen e Asamblese se Ortakve ku me vendimin Nr. 1 ka vendosur;

- Ndryshimin i emrit te shoqerise nga "LEGEA" sh.p.k. ne "LEGA SPORT" sh.p.k. Ky ndryshim i emrit ka ardhur si rezultat i te qenit me afer objektit dhe veprimtarise se shoqerise.

Per sa me siper duke qene se vendimi i asambles eshte miratuar me unanimitetin nga te tre ortaket themelues te kesaj shoqerie, Ylli TOMORI, Fatmir HAJDINI dhe Kejdi TOMORI dhe eshte ne pajtim me ligjin dhe statutin e shoqerise, mendoj se kerkesa e mesiperme duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te neneve 60, 61 te ligjit 7638 "Per shoqerite tregtare"


VENDOSA


Pranimin e kerkeses per regjistrimin e vendimit Nr 1, date 05.04.2007 te Asambles se Ortakve te shoqerise "LEGEA" sh.p.k per:

- Ndryshimin e emrit te shoqerise nga "LEGEA" sh.p.k. ne "LEGA SPORT" sh.p.k.

- Te behet Regjistrimi i ketij vendimi ne Regjistrin Tregtar te Gjykares se Rrethit Gjyqesor Tirane me shenimet perkatese ne kolonen e regjistrit .

GJYQTAR





AKT THEMELIMI I SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "LEGEA" SH.P.K

Sot, me date 03.03.2006, me cilesine e ortakeve themelues, ne :

1. Ylli TOMORRI, i biri i Skenderit dhe i Vitos, i dtl. 04.11.1950, lindur dhe banues ne Tirane ne adresen Rr. "Kavajes", Pallati "SPEED", Shk.1, Ap. 12/1, me shtetesi dhe kombesi Shqiptare, madhor me zotesi te plota juridike dhe per te vepruar, mbajtes i pasaportes Nr. Z 1027399
2. Fatmir HAJDINI, i biri i Asllanit dhe i Anifes, i dtl. 15.01.1953, lindur dhe banues ne Tirane ne adresen Rr. "Kavajes", Pallati SPEED, Shk.1, Ap.7/3, me shtetesi dhe kombesi Shqiptare, madhor, me zotesi te plota juridike dhe per te vepruar, mbajtesi i pasaportes Nr.Z 1014299.
3. Kejdi TOMORRI, i biri i Yllit dhe i Ermires, dtl. 20.04.1980, lindur dhe banues ne Tirane ne adresen Rr. "Kavajes", Pallati. "SPEED" Shk.1 , Ap. 8/1, me shtetesi dhe kombesi Shqiptare, madhor, me zotesi te plota juridike dhe per te vepruar, mbajtesi i pasaportes nr. Z 1675352.

vendosem te themelojme Shoqerine Tregtare "LEGEA" sh.p.k.

Me nenshkrimin e ketij akti themelimi, ne nenshkruesit dhe themeluesit e tij marrim persiper te realizojme e respektojme te drejtat dhe detyrimet me saktetesimet e meposhtme :

NENI 1

Shoqeria Tregtare "LEGEA" sh.p.k. eshte formuar si person juridik shqiptar ne perputhje me kerkesat e ligjit Nr.7638 date 19.11.1992.

NENI 2

Shoqeria e ka seline e sajne ne Tirane, ne adresen Rr. "Kavajes", Pallati. "SPEED" Shk.1 , Ap. 8/1.

Kohezgjatja e shoqerise do te jete 40-vjet, por ky afat mund te nderpritet apo te zgjatet me tej, gjithmone ne funksion te kompetencave te asamblese se ortakeve themelues.

NENI 3

Si rregull aktiviteti i shoqerise mund te zhvillohet ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise, por ai mund te ushtrohet dhe jashte ketij territori, me hapjen e filialeve apo nepermjet veprimtarive te tjera te karakterit tregtar, ne perputhje me legjislacionin perkates.

NENI 4

Themeluesit e Shoqerise Tregtare "LEGEA" sh.p.k. me kete akt themelimi, marrin persiper qe te respektojne te gjitha detyrimet qe parashikon legjislacioni shqiptar dhe sidomos ai tregtar e civil per shoqerite tregtare me pergjegjesi te kufizuar.

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njqind mije) leke i derdhur teresisht ne Banke.

Kapitali themeltar perbehet nga kontributi i meposhtem :

1. Z. Ylli Tomorri 33.000 (tridhjetetremije) leke .
2. Z. Fatmir Hajdini 33.000 (tridhjetetremije) leke.
3. Z. Kledi Tomorri 34.000 (tridhjetekatermije)leke.

Ne baze te kontributit te siperpermendur, kapitali eshte ndare ne pjese te barabarta ku vlera nominale (kuota) u percaktua 100.000 leke.

Te gjitha pjeset qe formojne kapitalin themeltar, nenshkruhen, shlyhen plotesisht, pastaj i shperndahet ortakve sipas ndarjes se mesiperme.

Me legalizimin e Shoqerise ne organet kompetente te shtetit Shqiptar dhe me fillimin e ushtrimit te aktivitetit, kapitali themeltar i kesaj shoqerie mund te zmadhohet.

Shoqeria mund ta zvogeloje kapitalin e saj. Zvogelimi i kapitalit vendoset nga vendimi i asamblese se ortakve por jo me pak se minimumi i lejuar per kete qellim nga ligji.

NENI 6

Objekti i veprimtarise se Shoqerise Tregtare "LEGEA" sh.p.k do te jete:

- Import Eksport, tregtim me shumice e pakice, te mallrave te ndryshme si konfeksione, ushqimore, industriale e sportive.
- Pervec sa me siper, ne veprimtarine e shoqerise do te hyje cdo veprimtari tjeter industriale e tregtare, qe do te konsiderohet nga ortaket, e nevojshme dhe e pershtatshme per arritjen e objektit te shoqerise.

NENI 7

Ortaket Themelues kane vendosur qe administrator i Shoqerise te jete z . Ylli Tomorri qe eshte dhe nje nga ortaket themelues.

Ai do te pergjigjet mbi bazen e kompetencave te percaktuara ne aktet e themelimit te shoqerise si dhe ne statutin e saj.

Gjithashtu ai pergjigjet per administrimin e vlerave pasurore te Shoqerise, te cdo natyre qofshin, te shlyeje detyrimet qe ka shoqeria me te tretet, te beje mbi bazen e kontributeve te dhena prej ortakve shperndarjen e fitimit, etj.

Si organ ekzekutiv i Shoqerise Tregtare "LEGEA" sh.p.k., te drejtat dhe detyrat e administratorit rregullohen me statutin e shoqerise, me aktet e tjera normative te nxjera nga asambleja e ortakve, apo dhe me marreveshje te tjera te vecanta .

NENI 8

Mandati i Administratorit per administrimin e kesaj shoqerie eshte per nje periudhe te papercaktuar.

Administratori apo atij qe i delegohet ky funksion, ka te gjitha kompetencat te cilat ai deklarohet se i njeh dhe i pranon, per te kryer te gjitha detyrimet qe i linden ne baze te statudit te Shoqerise, sikurse dhe parashikohet ne legjislacionin Shqiptar dhe ne menyre te vecante ne "Tre Ligjet per Shoqerite Tregtare ". Kopetencat e veta ai mund t'ja

delegoje nje personi te trete me ane te prokures se posacme per kete qellim. I deleguari ka per kopetence vetem ato te percaktuara shprehimisht ne prokure.

NENI 9

Kjo Kontrate Themelimi hartohet ne 5-ekzemplare origjinale, duke patur sejcila prej tyre vlere te barabarte ngjore e kuptimore.

NENI 10

Ortaket, bien dakort me kete Akt-Themelimi te Shoqerise "LEGEA" sh.p.k te hartuar prej tyre, te cilin e nenshkruajne rregullisht dhe me vullnet te lire.

ORTAKET THEMELUES

YLLI TOMORRI

Ylli Tomorri
Ylli

FATMIR HAJDINI

Fatmir Hajdini
Hajdini

KEJDI TOMORRI

Kejdi Tomorri
Kejdi



STATUT
I
SHOQERISE TREGTARE "LEGEA" sh.p.k.

HYRJE

Ne mbeshtetje te nenit 2, paragrafi i pare, shkronja "b" e ligjit " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire te veprimtarise private, te pavarur dhe te privatizimit" Nr. 7512 date 10.08.1991, te ligjeve tregtare Nr.7632 dt.04.11.1992, Nr. 7638, dt.19.11.1992 dhe Nr. 7667, dt. 28.01.1993 si dhe dispozitave perkatese te aktit te themelimit te Shoqerise Tregtare "LEGEA" sh.p.k..

PERSONAT E POSHTESHENUAR ME
CILESINE E ORTAKVE THEMELUES

1. Ylli TOMORRI, i biri i Skenderit dhe i Vitos, i dtl. 04.11.1950, lindur dhe banues ne Tirane ne adresen Rr. "Kavajes", Pallati. "SPEED", Shk.1, Ap. 12/1, me shtetesi dhe kombesi Shqiptare, madhor, me zotesi te plota juridike.
2. Fatmir HAJDINI, i biri i Asllanit dhe i Anifes, i dtl. 15.01.1953, lindur dhe banues ne Tirane ne adresen Rr. "Kavajes", Pallati "SPEEED", Shk.1, Ap.7/3, me shtetesi dhe kombesi Shqiptare, madhor me zotesi te plota juridike.
3. Kejdi TOMORRI, i biri i Yllit dhe i Ermires, dtl. 20.04.1980, lindur dhe banues ne Tirane ne adresen Rr. "Kavajes", Pallati. "SPEED" Shk.1 , Ap. 8/1, me shtetesi dhe kombesi Shqiptare, madhor, me zotesi te plota juridike dhe per te vepruar.

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

NENI 1

Shoqeria Tregtare "LEGEA" sh.p.k., eshte nje shoqeri ne pronesi private ku nepermjet ketij statuti, aktit e saj te krijimit si dhe legjislacionin shqiptar, rregullon poziten juridike te ortakve, te organeve drejtuese si dhe te punonjesve te shoqerise, te dhenat me rendesi per poziten juridike te ortakve ne raport me shoqerine dhe te tretet, organizimin dhe objektin e veprimtarise se saj si dhe ceshtjet e tjera me rendesi per mbarevajtjen e Shoqerise "LEGEA" sh.p.k. si dhe per mardheniet me te tretet.

NENI 2

Shoqeria eshte krijuar nepermjet aktit te themelimit per krijimin e Shoqerise ne pronesi private me kontributin nominativ te Ortakve Themelues.

NENI 3

Shoqeria ka statusin e personit juridik te formes shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k), statut qe persa kohe nuk cedohet nga ortakët themelues, njehesohet me aktet ligjore qe rregullojne mardheniet juridike te ketyre fushave.

NENI 4

Shoqeria "LEGEA" sh.p.k. është person juridik shqiptar dhe si e tille, vepron ne te gjithë teritorin e Republikës së Shqipërisë si dhe dhe jashtë saj.

Shoqeria e ka selinë e sajë ne Tirane, ne adresen Rr. "Kavajes", Pallati "SPEED", Shk.1, Ap. 8/1

NENI 5

Shoqeria fiton te drejtat e personit juridik mbas rregjistrimit ne rregjistrat perkates prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

NENI 6

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e sajë ne perputhje me dispozitat e Aktit te Themelimit, te Statutit dhe konform kerkesave te Legjislacionit Shqiptar.

Me legalizimin e Shoqerise ne organet kompetente te shtetit Shqiptar dhe me fillimin e ushtrimit te aktivitetit te sajë, kapitali themeltar i kesaj shoqerie mund te zmadhohet.

Mosmarreveshjet eventuale midis ortakeve dhe shoqerise nga njera ane dhe personave te tjere fizike dhe juridike shqiptare ose te huaj zgjidhen sipas legjislacionit shqiptar.

Neni 7

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise është 100.000 (njqinde mije) leke i derdhur teresisht ne Banke.

Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar nepermjet shtimit te pjeseve te reja, ortakët kane te drejten e perparësisë ne nenshkrim ne proporcion me shumen e shtuar.

Kapitali themeltar perbehet nga kontributi i meposhtem :

Z. Ylli Tomorri 33.000 (tridhjetetremije) leke .

Z. Fatmir Hajdini 34.000 (tridhjetetremije) leke.

Z. Kejdi Tomorri 34.000 (tridhjetekatermije)leke.

Ne baze te kontributit te siperpermendur kapitali është ndare ne pjese te barabarta ku vlera nominale (kuota) u percaktua 100leke.

Te gjitha pjesët qe formojne kapitalin themeltar, nenshkruhen, shlyhen plotesisht, pastaj i shperndahet ortakve sipas ndarjes se mesiperme.

NENI 8

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise është percaktuar 40-vjet, por asambleja e ortakeve mund te vendose per zgjatjen e ketij afati.

Kerkesa per zgjatjen e afatit te veprimtarise duhet paraqitur 3 muaj perpara perfundimit te ketij afati.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 9

Objekti i veprimtarise se Shoqerise Tregtare "LEGEA" sh.p.k do te jete:

Import Eksport, tregetimi me shumice e pakice i mallrave te ndryshme si konfeksione, ushqimore, industriale e sportive.

Përveç sa me sipër, në veprimtarinë e shoqërisë do të hyjë çdo veprimtari tjetër industriale e tregtare, që do të konsiderohet nga ortakët, e nevojshme dhe e përshtatshme për realizimin e objektivit të veprimtarisë së shoqërisë.

NENI 10

Për realizimin e kësaj veprimtarie, përveç qendres në qytetin e Tiranës, Shoqëria mund të hapë degë, zyrë apo filiale përkatëse të saj duke u mbështetur në legjislativonin shqiptar. Shoqëria mund të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj, emërtimin dhe seline, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 11

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj për të realizuar fitim, duke u mbështetur në parimet e likuiditetit, sigurisë dhe rentabilitetit si dhe vetëm mbi bazën e legjislativonit shqiptar.

Shoqëria i ka të gjitha autorizimet në marrëdhëniet juridike me persona të tjerë.

NENI 12

Për detyrimet e veta, të krijuara në veprimtarinë e saj me persona të tjerë, Shoqëria përgjigjet në bazë të kapitalit themeltar të derdhur nga Ortakët Themelues.

MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQËRISE

Neni 13

Organet drejtuese të Shoqërisë Tregtare "LEGEA" sh.p.k, janë :

- 1) Asambleja e ortakëve të shoqërisë.
- 2) Administratori i Shoqërisë i caktuar nga Asambleja e Ortakëve.

Neni 14


Asambleja e ortakëve

Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë. Ajo mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme. Vendimet e Asamblesë, të marra në përputhje me ligjin dhe statutin e aktin e themelimit, kanë fuqi detyruese për të gjithë organizmat e shoqërisë, edhe pse jo të pranishëm dhe jo dakort.

Asambleja e zakonshme vendos për çështje të tilla si emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertët kontabel të autorizuar dhe likuiduesve, miratimi i raporteve të administrimit dhe të kontrollit, miratimi i llogarive vjetore, ndarja e fitimit etj. Ajo është e vlefshme kur në të marrin pjesë ortakët të cilët zoterojnë më shumë se 50% të vlerës së kontributeve.

Në mbledhjen e Jashtëzakonshme Ortakët vendosin për çështje të tilla si ndryshimet e statutit, zvogëlimi i kapitalit themeltar, transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar tek të tjerët, zgjatja e kohës së veprimtarisë së shoqërisë apo likuidimi i saj, shndrimi i shoqërisë në formë të tjera të organizimit etj. Ajo është e vlefshme kur në të marrin pjesë ortakët të cilët zoterojnë më shumë se 75% të kapitalit themeltar.

Mbledhja drejtohet nga njëri prej Ortakëve përgjithësisht nga ai që është dhe njëkohësisht Administrator.



Verbalet e mbledhjes perpilohen, aprovohen dhe firmosen nga ortaket pjesmarres, kur nuk perpilohen nga nje noter.

Neni 15

ADMINISTRIMI

Shoqeria administrohet nga nje Administrator, qe ne rastin konkret eshte Z. Ylli Tomorri qe eshte dhe ortak themelues i shoqerise.

Administratori i shoqerise pergjigjet per punen e tij para Asamblese se Ortakeve. Ai emerohet ose shkarkohet me vendim te arsyetuar. Mandati i Administratorit nuk eshte i kufizuar pervec rasteve kur ai nderpritet me vendim te Asamblese.

Administratori i Shoqerise mund te zevendesohet perkohesisht nga nje person tjetër i cili gezon ato kompetenca qe i delegon Administratori ne menyre te shkruar.

NENI 16

Administratori i Shoqerise, drejton gjithë veprimtarine e Shoqerise ne pikpamjen tekniko-organizative dhe ka keto kompetenca :

Perfaqeson Shoqerine ndaj personave te trete;

Pergjigjet para Asamblese per ligjshmerine e punes se shoqerise si dhe per aktivitetin ekonomik e financiar te sajë ;

Ka te drejte te lidhe kontrata, te kryeje pune e veprime te tjera juridike brenda autorizimeve te dhena nga Asambleja dhe pasi te kete marre me pare pelqimin e sajë.

Percakton sipas nje miratimi paraprak strukturen organizative te shoqerise, kompetencat e drejtuesve te tjere te sektoreve te vecante.

NENI 17

Administratori mund te shkarkohet kur asambleja verteton se ai eshte pergjegjes per mos arritjen e rezultateve afariste te Shoqerise, humbet besimin e saj, ose kerkon te largohet me kerkesen e tij, si dhe ne rastet e tjera te parashikuara me ligj.

Neni 18

EKSPERTET KONTABEL TE AUTORIZUAR

Ne rast nevojë ose nese e kerkon ligji, kontrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar i emertuar per tre vite financiare, me mundesi rizgjedhje nga Asambleja e Ortakeve.

Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kushte si dhe emerimi, ne rast se verehen gabime ose behet e pamundur kryerja e detyres si dhe ne cdo rast tjetër kur asambleja e konsideron te nevojshme.

NENI 19

Shoqeria kryen veprimtarine e sajë me mjetet e investuara ne fondet e sajë dhe me mjetet e tjera. Ajo eshte e detyruar qe vellimin e punes ta ushtroje ne vartesi me shumen e mjeteve te investuara ne fondin themeltar te Shoqerise dhe nga shuma e mjeteve te rezerves.

Shoqeria percakton fondet e meposhtme:

- 1) Fondin Themeltar;
- 2) Fondin Rezerve

Per ushtrimin e veprimtarise se saje Shoqeria mund te percaktoje dhe fonde te tjera.

NENI 20

Fondi themeltar formohet nga mjetet e investuara nga ortakët themelues dhe nga mjetet e tjera ne para ose ne cdo forme tjeter te investuar.

Shoqeria shfrytëzon fondin themeltar per ushtrimin e veprimtarise se saj, per investime ne fondet e personave te tjere juridike dhe fizike si dhe per te perballuar rreziqet pas shfrytëzimit te mjeteve te rezerves. Gjithashtu mund ti shfrytëzoje edhe per destinime te tjera sipas interesit te shoqerise.

NENI 21

Fondi rezerve i shoqerise formohet nga nje pjese e fitimit qe shoqeria realizon gjate veprimtarise se saje. Ajo percaktohet me nje vendim te vecante te Asamblese se Ortakëve. Fondi rezerve mund te perdoret edhe per destinacione te tjera qe jane ne perputhje me interesat e shoqerise.

Pas miratimit te bilancit dhe raportit financiar vjetor nga Asambleja e Shoqerise, pjesa e fitimit neto mund te ndahet vetem me vendim te organit te mesiperm pa veshitësuar zhvillimin e aktivitetit te shoqerise.

NENI 22

Forma e balanceve dhe librave te llogarise qe do te mbaje shoqeria, percaktohen nga Asambleja e Ortakëve te Shoqerise, mbi bazen e ligjit perkates dhe sikurse parashikohet ne statut.

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE

NENI 23

Fitimi i shoqerise percaktohet nga bilanci vjetor i veprimtarise ekonomiko-financiare te Shoqerise.

Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.


Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratorët dhe eventualisht, nga eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga Asambleja e Ortakëve.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine e vjetore behet brenda nje afati te caktuar deri ne 6 muaj nga data e mbylljes se vitit financiar.

Neni 24

DIVIDENTET

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te egzistences se fitimeve, mbledhja e ortakve percakton pjesen qe u takon atyre ne formen e dividendeve mbi fitimin. Fitimi qe do te ndahet ne proporcion me pjeset e kapitalit themeltar, perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per fondin rezerve te domosdoshem (minimumi 5% e fitimit te cdo viti) dhe nga ana tjeter i jane zbritur ose shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme.



NENI 25

Ne qofte se ne bilancin vjetor Shoqeria nuk del me fitim por me humbje, ato do te mbulohen ne perputhje me kuoten e investuar me rastin e krijimit te Shoqerise.

Nese mbas kryerjes se veprimit te parashikuar nga paragrafi i mesiperm, ortaket nuk do ta mbulojne kete humbje, ndaj Shoqerise hapet procedura e likuidimit (falimentimit) ne rast se vazhdimi i metaishem i aktivitetit te saj ekonomiko-financiar eshte i pamundur.



MARRËDHENIET E PUNES

NENI 26

Mardheniet e punes ne shoqeri rregullohen ne perputhje me legjislacionit shqiptar, kontraten per krijimin e shoqerise, dhe me kete statut.

NENI 27

Punonjesi eshte personalisht pergjegjes per kryerjen e punes se caktuar ne menyre te ligjeshme dhe profesionale.

Administratori eshte pergjegjes per kryerjen e puneve qe rrjedhin nga kompetencat e tij

Administratori, pergjegjesat e sektoreve dhe punonjesit e tjere te shoqerise, bartin dhe pergjegjesine materiale per marrjen e vendimeve jo ligjore, te cilat demtojne materialisht shoqerine dhe ortaket themelues te shoqerise, ne vartesi nga ndikimi i tij per marrjen dhe zbatimin e vendimeve te tilla.

Te gjithë personat e mesiperm, te parashikuar ne paragrafin e pare te ketij neni, do te pergjigjen per demet civile te shkaktuara, sipas legjislacionit.

NENI 28

Sekreti i punes ne Shoqeri eshte i detyrueshem te ruhet nga te gjithë punonjesit e Shoqerise.

NENI 29

Sekrete te punes paraqesin shkresat, aktet dhe vendimet e nxjerra nga Asambleja dhe qe jane te shpallura prej saje si sekrete te punes. Per shkelje te nenit 28, si mase merret largimi nga puna e punonjesit dhe ne rast se nga kjo shkelje shoqeria ka patur dem material efektiv, personi fajtor do te pergjigjet sipas legjislacionit penal e civil shqiptar.

ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

NENI 30

Shoqeria priset me perfundimin e afatit te percaktuar ne nenin 8 te ketij statuti, me perjashtim te rasteve kur ka nje prishje te parakohshme per arsyet e parashikuara me ligj.

Shoqeria nuk priset kur njeri prej ortakeve falimenton, behet i paafte ose vdes.

NENI 31

Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi Asambleja emerohet nje ose disa likujdues, te cilet i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit te shoqerise mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

NENI 32

Shnderrimi i Shoqerise

Shnderimi i Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri kolektive ose komandite mund te kryhet vetem me miratimin unanim te ortakeve ndersa shnderimin ne shoqeri anonime me miratimin e shumices se ortakeve qe zoterojne mbi $\frac{3}{4}$ e pjeseve te kapitalit themeltar

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 33

Per te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise ose periudhes se likuidimit ndermjet ortakeve apo ndermjet shoqerise dhe ortakeve kompetente do te jete Gjykata e Rethit Tirane.

NENI 42

Per gjithcka qe nuk eshte parashikuar ne kete statut do te respektohen normat ligjore per kete ceshtje te shtetit shqiptar dhe kur nevojitet atij nnderkombetar.

NENI 43

Ky Statut hyn ne fuqi ditën e nenshkrimit nga ortaket themelues te Shoqerise para nje noteri publik.

ORTAKET THEMELUES

YLLI TOMORRI

Ylli Tomorri
[Signature]

FATMIR HAJDINI

Fatmir Hajdini
[Signature]

KEJDI TOMORRI

Kejdi Tomorri
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 1816 Rep.
Nr. — Kol.



Sot me dt. 17 Mars 2006, u paraqiten para meje, noterit publik, personat e meposhtem :

Ylli TOMORRI, i biri i Skenderit dhe i Vitos, i dtl. 04.11.1950, lindur dhe banues ne Tirane ne adresen Rr. "Kavajes", Pallati. "SPEED" Shk.1, Ap. 12/1, me shtetesi dhe kombesi Shqiptare, madhor, me zotesi te plota juridike dhe per te vepruar, mbajtes i pasaportes me Nr. Z 1027399


Fatmir HAJDINI, i biri i Asllanit dhe i Anifes, i dtl. 15.01.1953, lindur dhe banues ne Tirane ne adresen Rr. "Kavajes", Pallati SPEEED, Shk.1, Ap. 7/3, me shtetesi dhe kombesi Shqiptare, madhor, me zotesi te plota juridike dhe per te vepruar, mbajtes i pasaportes Nr. Z 1014299.

Kejdi TOMORRI, i biri i Yllit dhe i Ermires, i dtl. 20.04.1980, lindur dhe banues ne Tirane ne adresen Rr. "Kavajes", Pallati. "SPEED" Shk.1, Ap. 8/1, me shtetesi dhe kombesi Shqiptare, madhor, me zotesi te plota juridike dhe per te vepruar, mbajtes i pasaportes Nr. Z 1675352.

Te cilet, me deklaruan se me vullnetin e tyre te lire kane hartuar jashte kesaj zyre Statutin e Shoqerise Tregetare "LEGEA" sh.p.k te cilin dhe e neneshkruajne pa verejtje ne pranine time, dhe une noteri e vertetoj sipas ligjit.

NOTERI

NOTERE
MARGENALCELA
CEL: 069 21 21 624



**VENDIM Nr. 1
I ASAMBLES SE ORTAKVE THEMELUES TE
TE SHOQERISE TREGTARE
"LEGEA" sh.p.k.**

Sot me date 05.04.2007, ne Tirane, ne selin e shoqerise "LEGEA" sh.p.k. u zhvillua asambleja e ortakeve themelues me kete rend dite:

1. Ndryshimi i emrit te shoqerise tregtare nga "LEGEA" sh.p.k. ne "LEGA SPORT" sh.p.k.

Ne mbledhje marrin pjese te tre ortaket themelues te shoqerise dhe konkretisht zotrinjte:

1. Ylli Tomori, i biri i Skenderit dhe i Vites, i datelindjes 04.11.1950, lindur dhe banues ne Tirane, ne adresen: rruga e "Kavajes" pallatet "SPEED" shk. 1 ap.12/1 administrator i Shoqerise tregtare "LEGEA" sh.p.k.
2. Fatmir Hajdini i biri i Asllanit dhe i Anifes i datelindjes 15.01.1953, lindur dhe banues ne Tirane ne adresen: rruga " Kavajes" pall "SPEED", shk. 1, ap. 7/3.
3. Kejdi Tomori i biri i Yllit dhe Ermirës i datelindjes 20.04.1980, lindur dhe banues ne Tirane ne adresen: rruga e " Kavajes" pall "SPEED", shk. 1, ap. 8/1.

Asambleja u drejtua nga z. Ylli Tomori, administrator i shoqerise, i cili pasi beri nje ekspoze te aktivitetit tregtar te ushtruar deri me tani parashtroi se;

Per nje mire administrim te aktivitetit te shoqerise dhe duke qene se kjo shoqeri merret kryesisht me importimin e arktikave sportive eshte e nevojshme qe emri i saj te jete me afer natyres dhe veprimtarise se kesaj shoqerie. Ne keto kushte emri "LEGA SPORT" sh.p.k vleresohet si me i pershtateshem per te zevendesuar emrin aktual te shoqerise, "LEGEA" shpk.

Ortaket e tjere themelues Fatmir Hajdini, Kejdi Tomori ne menyre unanime jane dakort me sa u propozua.

Per sa me siper asambleja e ortakeve themelues te shoqerise "LEGEA" sh.p.k ne menyre unanime

VENDOSI

1. Ndryshimin e emrit te shoqerise tregtare nga "LEGEA" sh.p.k. ne "LEGA SPORT" sh.p.k.

2. Depozitim, nga ana e administratorit, te ketij vendimi se bashku me kerkesen per miratim te ketij ndryshimi nga ana e Gjykates, ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor- Tirane, per tu bere shenimet perkatese ne rregjistrin tregtar.

**Ortaket Themelues te Shoqerise Tregtare
"LEGEA" sh.p.k**

Ylli TOMORI

Fatmir HAJDINI

Kejdi TOMORI

Ylli Tomori
[Signature]

Fatmir Hajdini
[Signature]

Kejdi Tomori
[Signature]

Z. T. Uo Xha
dt. 20.04.2007
20 APR. 2007 *ms*

K E R K E S E

KERKUESI: Ylli Tomori, i biri i Skenderit i datelindjes 04.11.1950, lindur dhe banues ne Tirane, ne adresen: rruga e "Kavajes" pallatet "SPEED" shk. 1 ap.12/1 administrator i shoqerise tregtare "LEGEA" sh.p.k.,

OBJEKTI: Ndryshimi i Statutit te Shoqerise Tregtare "LEGEA" sh.p.k, ne lidhje me emrin e shoqerise .

BAZA LIGJORE: Nenet 60, 61 te Ligjit Nr.7638 "Per shoqerite tregtare" si dhe statuti i shoqerise "LEGEA" sh.p.k.

PERPARA :

GJYKATES SE RRETHIT GJYQESORE

TIRANE

Shoqeria Tregtare "LEGEA" sh.p.k., eshte regjistruar ne regjistrin tregtar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane me vendimin Nr.35324 dt.28.03.2006.

Qe me krijimin e saj, shoqeria ka ushtruar nje aktivitet tregtar ne perputhje me objektin e veprimtarise te percaktuar ne statutin dhe ne aktin e themelimit te saj.

Me vendimin Nr. 1, date 05.04.2007 te asamblese te ortakeve themelues te shoqerise eshte vendosur te ndryshohet emrit te shoqerise nga "LEGEA" sh.p.k. ne "LEGA SPORT" sh.p.k.

Duke qene se ne mbledhje kane marre pjese te tre ortaket themelues te shoqerise tregtare "LEGEA" shpk, te cilet zoterojne 100% te kuotave te kapitalit themelitar, vendimi i mesiperme eshte i vlefshem persa i perket pjesmarrjes ne asamble. Po keshtu duke qene se vendimi eshte marre ne unanimitet nga ortaket vendimi eshte i vlefshem edhe per kete arsye.

Per sa me siper kerkoj qe te shqyrtoni kerkesen e mesiperme dhe sipas objektit te saj te vendosni per :

- Regjistrimin e vendimit Nr. 1, date 05.04.2007 te Asambles se Ortakve Themelues te shoqeris "LEGEA" sh.p.k. ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesore Tirane.

Bashkangjitur me kerkesen ju paraqesim:

- Vendimin Nr 1, date 05.04.2007 te Asambles se Ortakeve Themelues
- Vendimin e regjistrimit te shoqerise "LEGEA" sh.p.k.


Per shoqerine "LEGEA" sh.p.k.
Administratori

YLLI TOMORI

Ylli Tomori
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 1816 Rep.
Nr. — Kol.



VERTETIM

Sot me dt. 17 Mars 2006, u paraqiten para meje noterit publik, personat e meposhtem :

Ylli TOMORRI, i biri i Skenderit dhe i Vitos, i dtl. 04.11.1950, lindur dhe banues ne Tirane ne adresen Rr. "Kavajes", Pallati. "SPEED" Shk.1, Ap. 12/1, me shtetesi dhe kombesi Shqiptare, madhor, me zotesi te plota juridike dhe per te vepruar, mbajtes i pasaportes me Nr. Z 1027399

Fatmir HAJDINI, i biri i Asllanit dhe i Anifes, i dtl. 15.01.1953, lindur dhe banues ne Tirane ne adresen Rr. "Kavajes", Pallati SPEEED, Shk.1, Ap. 7/3, me shtetesi dhe kombesi Shqiptare, madhor, me zotesi te plota juridike dhe per te vepruar, mbajtes i pasaportes Nr. Z 1014299.

Kejdi TOMORRI, i biri i Yllit dhe i Ermires, i dtl. 20.04.1980, lindur dhe banues ne Tirane ne adresen Rr. "Kavajes", Pallati. "SPEED" Shk.1, Ap. 8/1, me shtetesi dhe kombesi Shqiptare, madhor, me zotesi te plota juridike dhe per te vepruar, mbajtes i pasaportes Nr. Z 1675352.

Te cilet me deklaruan se me vullnetin e tyre te lire kane hartuar jashte kesaj zyre aktin e themelimit te Shoqerise Tregetare "LEGEA" sh.p.k te cilin dhe e nenshkruajne pa verejtje ne pranine time, ku une noteri e vertetoj sipas ligjit.

NOTERI

NOTERE
MARGENA CELA
CEL: 069 21 21 624



30329

J. E. Kego
20.03.2006
20 MARS 2006

K E R K E S E

KERKUESI: Ylli TOMORRI, i biri i Skenderit dhe i Vitos, i dtl. 04.11.1950, lindur dhe banues ne Tirane ne adresen Rr. "Kavajes", Pallati. "SPEED", Shk.1, Ap. 12/1, me shtetesi dhe kombesi Shqiptare, madhor, me zotesi te plota juridike dhe per te vepruar.

OBJEKTI: Kerkohet rregjistrimi ne Rregjistrin Tregtar si person juridik te Shoqerise Tregtare "LEGEA" sh.p.k

Baza Ligjore: Ligji Nr. 7667 date 28.01.93 "Per Rregjistrin Tregtar", dhe ligji Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare".

Per para:

GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR

TIRANE

28

I nderuar Z. Kryetar !

Ne baze te Aktit te Themelimit dhe te Statutit eshte themeluar Shoqeria Tregtare "LEGEA" sh.p.k me ortak themelues shtetasit Shqiptare Ylli Tomorri, Fatmir Hajdini ne Kejdi Tomorri

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie do te jete si me poshte:
Import Eksport, tregtimi me shumice e pakice i mallrave te ndryshme si infeksione, ushqimore, industriale e sportive.

Pervec sa me sipër, ne veprimtarine e shoqerise do te hyje cdo veprimtari tjetër industriale e tregtare qe do te konsiderohet nga ortakët, e nevojshme dhe e pershtatshme per arrijten e objektit te veprimtarise se shoqerise.

Kapitali themeltar i shoqeris eshte 100.000 leke. Ai eshte derdhur dhe zoterohet nga cdo ortak si me poshte :

- Z. Ylli Tomorri 33.000 (tridhjetetremije) leke .
- Z. Fatmir Hajdini 33.000 (tridhjetetremije) leke.
- Z. Kejdi Tomorri 34.000 (tridhjetekatermije)leke.

Sikurse rezultoi emri i shoqerise eshte "LEGEA" sh.p.k Selia e saj do te jete ne Tirane, Rr. "Kavajes", Pallati. "SPEED", Shk.1 , Ap. 8/1.

Perfaqesues Ligjor dhe Administrator i shoqerise jam zgjedhur une kerkuesi Ylli Tomorri, njeheresh dhe ortak themelues i shoqerise.

Kohezgjatja do te jete 40 vjet.

Per sa me sipër Ju lutem caktoni nje dite per shqyrtimin e kesaj kerkese e pasi te jyrtoni te gjitha aktet bashkalidhur te vendosni sipas objektit te saj.

Bashkangjitur me kerkesen : Akti i Themelimit, Statuti i Shoqerise si dhe mandat zesa e kapitalit themeltar.

K E R K U E S


Ylli Tomorri

Ylli Tomorri



0

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 1816 Rep.
Nr. — Kol.



VERTETIM

Sot me dt. 22 Mars 2006, para meje noterit u paraqit personalisht Z. Ylli Tomorri, i biri i Skenderit dhe i Vitos, i dtl. 04.11.1950, lindur dhe banues ne Tirane ne adresen Rr. "Kavajes", Pallati. "SPEED" Shk.1, Ap. 12/1, me shtetesi dhe kombesi Shqiptare, madhor me zotesi te plota juridike dhe per te vepruar, mbajtes i pasaportes me Nr. Z 1027399, i cili me deklaroi se me vullnetin e tij te lire ka hartuar jashte kesaj zyre kerkesen drejtuar Gjykates per rregjistrimin e Shoqerise Tregetare "LEGEA" sh.p.k. te cilin dhe e neneshkruan pa verejtje ne pranine time, ndersa une noteri e vertetoj sipas ligjit.


NOTERI

NOTERE
MARGENA CELA
CEL: 069 21 21 624

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA E TIRANES

Nr. 38 Rep



VERTETIM

Vertetohet se sot me date 17.03.2006 para
neje noteres u paraqit z.Ylli Tomori bënues ne Tirane i
cili depozitoi shumën 100.000 leke per krijimin e
shoqerise tregtare " LIGJEA " SHPK dhe une notere e
vertetoj sipas ligjit.

NOTERE

~~NOTERE
MARGENA ÇELA
CEL: 069 21 21 624~~